

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-114/12

**Prishtinë ,
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të:

D. S.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

H. U.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/142/2012 (dosja e regjistruar në AKP me numrin KPA14615), i datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 12 nëntor 201, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. S. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/142/2012, i datës 29 shkurt 2012 ,sa i përket ankesës të regjistruar në KPA me numrin KPA14615.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPPC/D/A/142/2012, i datës 29 shkurt 2012 .

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 13 nëntor 2006, D. S. e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-ngastrës 2923 që gjendet në zonën kadastrale Korishë, si dhe regjistrimin e asaj prone në operativin kadastral për 1/3 e pjesës ideale. Ai pretendon se është pronar i kësaj prone sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998.Këtë aktgjykim e paraqet si dokument valid të së drejtës së pronësisë.

Sipas raportit të verifikimit të AKP-ës i 14 gusht 2007, ky aktgjykim është verifikuar pozitivisht.

Paraqitësi i kërkesës thekson se këtë pronë e ka humbur për shkak rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, duke theksuar datën e humbjes me 13 qershor 1999.

Kërkesa është regjistruar me numër KPA14615.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një sërë dokumentesh tjera, por që nuk janë relevante për këtë çështje juridike.

Në vitin 2007 dhe 2010, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej prona e paluajtshme dhe konstatuan që ajo pronë shfrytëzohej nga H. U. i cili ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj prone Ai theksoi se këtë pronë e ka blerë sipas marrëveshjes gojore nga U. I. por nuk ka paraqitur asnjë provë për ta mbështetur këtë pretendim.

Më 29 shkurt 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPPC/D/A/142/2012, e hodhi poshtë kërkesën e D. S. si çështje e gjykuar apo res judicata, sipas nenit 11.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Kjo me arsyetim se, e

njëta kërkesë e tije për të për të njëjtën pronë të paluajtshme me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998,është vërtetuar që ai është pronar i ngastrës kadastrale 2923 të regjistruar në zonën kadastrale Korishë.

Më 07 gusht 2012, vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 24 gusht 2012(në tekstin e mëtejme: pala ankuese).Më 06 shtator 2012 vendimin e pranoi pala përgjegjëse në kërkesë. Pala përgjigje në ankesë ankesën e pranoi me 13 nëntor 2012,por nuk paraqiti përgjigje në ankesë.

Paraqitësi i ankesës e kundërshton vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural. Ai pretendon se, procedura gjyqësore për drejtën e pronës për pronën e paluajtshme që është objekt i kërkesës së tij ka përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998,para Rregullores së UNMIK-ut 2006/50,dhe se ajo për këtë shkak, nuk ka mundur ta hedh këtë kërkesë.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që duke ia pranuar ankesën t'i mundësohet e drejta e posedimi në pronën e paluajtshme që është objekt i kërkesës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore, sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka vendosur me vendimin ankimor që ta hedh kërkesën e D. S. për shkak të çështje së gjykuar apo res judikata sipas nenit 11.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se Komisioni e hedh kërkesën nëse ajo është shqyrtuar dhe vendosur më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kjo ngase, kërkesa e ankuesit është shqyrtuar dhe vendosur me aktgjykimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998.Me këtë aktgjykim i është pranuar e drejta e pronësisë që është objekt i kërkesës. Prandaj, janë të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit se pranimi i të drejtës së pronës që është objekt i kërkesës sipas aktgjykimit të theksuar të formës së prerë para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50,nuk ka mundur të jetë shkak i hedhjes së kërkesës së tije.

Në procedurën ankimore ankuesi nuk paraqiti dëshmi tjera që nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të KPCC.

Prandaj sipas nenit 166 të LPK-ës i cili mutatis mutandis zbatohet sipas nenit 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashikohet se nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike ,për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.

Në bazë të gjendjes së tillë të konstatimeve faktike ,Gjykata Supreme vlerëson se, tërësisht dhe saktësisht ekziston identiteti, subjektiv, objektiv dhe e njëjta bazë faktike dhe juridike në mes të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998 dhe kërkesës së D.S. e paraqitur në AKP me numër të evidencës 14615. Prandaj, qartazi rezulton konkludimi juridik se kjo çështje është *res judicata*.

Nuk është kontestuese se, Gjykata Komunale në Prizren sipas aktvendimit E.nr.212/03 i dt. 13 prill 2006,ka miratuar propozimin e Z. V., në cilësinë e kreditore për tërheqjen të propozimit të ekzekutimit të pjesshëm të aktgjykimit të theksuar që i referohet ngastrës nr.2923 të zonës kadastrale Korishë. Sipas këtij aktvendimi ankuesin e ka përfaqësuar kreditorja Z. V.. Nga kjo mund të konstatohet se ankuesi vullnetarisht mbi bazën e disponueshmërisë (non ultra petita) ka hequr dorë nga ekzekutimi i aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.726/97 i dt.20 prill 1998. Ankuesi duke hequr dorë nga ekzekutimi i këtij aktgjykimi ai nuk ka interes juridik për mbrojtje gjyqësore sikundër nga KPKK-ja dhe rrjedhimisht nga Gjykata Supreme. Prandaj,dalin të pabazuara pretendimet e palës ankuese se nuk ka pasur mbrojtje juridike dhe gjyqësore të ligjshme dhe të drejtë.

Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it